



## Njoftim për shtyp

### **Tema: Projekti i Bashkimit Evropian “GEO-CRADLE” u lançua me sukses me qëllimin krijimin e një rrjetit aktorësh dhe një Qendre të Dhënash për Vëzhgimin e Tokës në Afrikën e Veriut, Lindjen e Mesme dhe Ballkan**

Athinë, Greqi, 18 – 19 Shkurt 2016 - **GEO-CRADLE**, një projekt i koordinuar nga Observatori Kombëtar i Athinës (NOA) dhe i financuar nga Programi Horizon 2020 i Bashkimit Evropian nisi me sukses në sfondin e qendrës historike të qytetit të Athina.

Takimi dy ditor që shërbeu si për lançimin e projektit, ashtu edhe për takimin e parë rajonal të punës, u organizua në Qendrën emblematike Jonike. Eventi u ndoq nga 85 pjesëmarrës nga Afrika e Veriut, Lindja e Mesme dhe Ballkani, duke përfshirë përfaqësues të anëtarëve të konsorciumit GEO-CRADLE, zyrtarë nga Komisioni Evropian dhe sekretariati i GEO dhe aktorë të tjerë nga rajoni.

Konsorciumi GEO-CRADLE solli së bashku institutet kërkimore me famë, autoritetet publike, SME-të e specializuara dhe shoqata lider ndërkombëtare, duke kombinuar një shkallë të gjerë të ekspertizës në monitorimin e mjedisit të planetit përmes një ansambli të teknologjive të ndryshme të EO (p.sh. remote sensing, in-situ, sinergjisë së modeleve të avancuara) në fushat e Ndryshimeve Klimatike, Materialeve të Lëndëve të Para, Sigurisë Ushqimore dhe Energjisë. Si projekt koordinator Dr. Haris Kontoes, drejtor kërkimor i Observatorit Kombëtar të Athinës, nënvizoi në fjalimin e tij të hapjes se këta partnerë kanë bashkuar forcat me **objektivin e gjithëpërfshirjes për krijimin e rrjetit koordinues multi-rajonale** që do të:

- i. Mbështesë **integrimin efektiv të kapaciteteve ekzistuese të EO** (hapësirë/ajrore/ rrjetit të monitorimit në terren, modelimit dhe aftësive të shfrytëzimit të të dhënave dhe eksperiencave nga projektet e mëparshme),
- ii. Nxisë ndërveprimin për **angazhimin e komunitetit në tërësi të aktorëve të EO** (shkencëtar, ofrues të dhënash/shërbimesh, përdorues të të dhënave, organizatat qeveritare dhe vendimmarrësit),
- iii. Promovojë, përmes studimeve të dedikuara të fizibilitetit, **arritjen konkrete të shërbimeve të EO dhe të dhënave në përgjigje të nevojave rajonale** përmes katër prioritetëve tematike: përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike, përmirësimit të sigurisë ushqimore, aksesit në lëndët e para dhe energjisë,
- iv. Kontribuojë në **zbatimin e përmirësuar dhe pjesëmarrjen në GEO, GEOSS dhe Copernicus në rajon.**

Në këtë kontekst, GEO-CRADLE do të përcaktojë krijimin e një Qendre të Dhënash rajonale që do të shërbejë si një “one-stop-shop” që do të lehtësojë aksesin në të dhe shpërndarjen e të dhënave gjeo-hapësinore dhe informacionit të grumbulluar nga satelitët dhe rrjetet më bazë tokësore. Më tej, Portali i GEO-CRADEL do të veprojë si një ndërveprues midis shkencëtarëve dhe prodhuesve të të dhënave të ndryshme, duke ofruar një pikë të vetme për aktorët për identifikimin e të dhënave ekzistuese, aftësive, boshllëqeve dhe plotësuesve, të nevojshme për zhvillimin e sinergjive dhe tregut të mundësive përmes zinxhirit të plotë të vlerave dhe në lidhje me prioritetet rajonale. Duke bërë këtë. GEO-CRADLE aspiron të katalizojë më tej promovimin dhe lidhjen e të dhënave dhe shërbimeve të Copernicus brenda rajonit, ndërsa avantazhon integrimin e kapaciteteve të EO të Afrikës së Veriut, Lindjes së Mesme dhe Ballkanit në Sistemin e Vëzhgimit Global të Tokës të Sistemeve GEOSS.

Sikurse u nënvizua në fjalimin hapës të Znj. Gaëlle Le Bouler, Projekt Oficere e Komisionit Evropian (përfaqësuese e Agjencisë Ekzekutive për Ndërmarrjet e vogla dhe të mesme – EASME), “integrimi i përdoruesve të të dhënave në këtë projekt është vendimtar që projekti t’i përgjigjet nevojave reale të tregut”. Për të përmbushur deri në fund këtë mision, aktivitetet e projektit kanë filluar me ndërtimin e një harte gjithëpërfshirëse të kapaciteteve rajonale të EO në katër fushat tematike (ndryshimet klimatike, siguria ushqimore, aksesit në lëndët e para dhe energjia) dhe një analize

tërësore të nevojave që i korrespondojnë përdoruesve të të dhënave.

Në këtë kontekst, GEO-CRADLE fton të gjithë aktorët rajonal të përfshihen në aktivitetet e projektit duke filluar më vëzhgimet e lançuara në fillim të prillit. Këto vëzhgime do të mbështetin identifikimin e boshllëqeve rajonale dhe sfidat dhe përpunimin e një pamjeje gjithëpërfshirëse të pjekurisë së EO në rajon. Vëzhgimet do të mbështeten nga kryerja e intervistave dhe mbushja e pyetësorëve specifikë të cilët do të bëhen të vlefshëm së shpejti në faqen e internetit të projektit. Të ndjekur nga katër studime fizibiliteti në fushat respektive tematike, këto aktivitete do të lehtësojnë rritjen e të dhënave dhe shërbimeve të EO në rajon, në mbështetje të mundësive më të mira të tregut për kompanitë e EO dhe SME-të dhe informimit të vendimmarrësve për përdoruesit e të dhënave. Organizatat nga Afrika e Veriut, lindja e Mesme dhe Ballkani, si nga sfera publike dhe ajo private, që i përkasin përdoruesve të të dhënave dhe/ose komuniteteve që ofrojnë shërbime/të dhëna do të përfitojnë nga plotësimi i pyetësorëve të vëzhgimit pasi do t'i lejojnë ata të shprehin nevojat e informacionit të tyre, për të informuar audiencën e gjerë rreth aftësive dhe kapaciteteve të tyre dhe do të bëhen pjesë e rrjetit të aktorëve rajonal i cili do të kërkojë të zbatojë GEO, GEOSS dhe Copernicus në të tre rajonet e projektit.



Kontakte:

**Koordinator i Përgjithshëm i Projektit:**

**OBSERVATORI KOMBËTAR I ATHINËS, Dr Haris KONTOES ([kontoes@noa.gr](mailto:kontoes@noa.gr))**

**GEO-CRADLE Veprim Koordinues dhe Mbështetës**

Kuadri i Programit H2020-Veprimi I klimës, mjedisi, eficientë e burimeve dhe lëndëve të para

**ACTIVITETI:**

Zhvillimi gjithëpërfshirës dhe i qëndrueshëm i mjedisit global të vrojtimit dhe sistemeve të informacionit

**IDENTIFIKUESI I THIRRJES:**

H2020 SC5-18b-2015 Integrimi i kapaciteteve të Vrojtimit të Tokës së Afrikës së Veriut, Lindjes së Mesme dhe Ballkanit në GEOSS

**Numri i Projektit GA: 690133**

**Autoriteti Kontraktues: KOMISIONI EVROPIAN**